



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

VENDIM

Nr. 128, datë 11.03.2026

PËR

**TRANSFERIMIN E GJYQTARES ZNJ. SUADA KURTI NË PROCEDURËN E
LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRES**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 85 e 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 7,10 dhe 12, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e tij nr. 236, datë 02.05.2024, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtares znj. Suada Kurti në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Gjyqtare znj. Suada Kurti, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore, çështjet penale me të pandehur që ndodhen nën masën e sigurimit “arrest në burg” dhe “arrest në shtëpi” për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, si dhe të gjitha çështjet ku është caktuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për

gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 24.03.2026.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. Suada Kurti, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR